

# VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 11 tetor 2005 | nr. 8 | www.vetevendosje.org



Foto: Rrezaart Galica - Gji

## UNITETI I PATOLERUESHËM I NEGOCIMIT TË LIRISË

Tash së fundi u krijua 'Grupi i Unitetit'. Le të themi - atij iu dha vetëm forma, sepse si gatishmëri ky grup ekzistonte qyshkur. Edhe ata të cilët bënë pak zhurmë, kundërshtuan vetëm sa për sy e faqe, për ta humbur në fund krejt fytyrën. Armiqtë e përbetuar politik befashtrëngojnë duart e qeshin paturpësisht para kamerave, e tëra që duket aty për aty është falsiteti i 'luftës' së tyre në skenën e mjerë politike. Ky grup, krejt çka po i tregon popullit është emri i tij - fjala e madhe 'unitet'. Por, jorastësisht, përmbajtja po fshehet me të gjitha format.

Sepse ky është uniteti institucional i negociimit të vetes sonë me Serbinë. Po bëhet pazar me lirinë e domosdo-

shme që ende s'e kemi. Çfarë demokracie është ky kur për proceset vendimtare kolektive, të cilat po e përcaktojnë fatin e një populli, nuk pyetet vetë ai? Populli nuk pyetet pikërisht ngaqë përgjigja e tij dihet: vullneti i tij nuk negociohet - ai duhet të zbatohet.

Sigurisht që po përgatitet kompromisi sepse tash gjashtë vjet janë bërë aq shumë kompromise, të cilat e garantojnë mundësinë e kompromisit madhor. Sigurisht se këta politikanë do ta pranojnë këtë kompromis madhor meqenëse e gjithë karriera e tyre është përplot kompromise të vogla e të mëdha, në dëm të popullit dhe interesave të tij. Tash e tutje, çdo frenim eventual i ndonjërit prej ty-

re do të jetë gjithnjë e më i vështirë. Theqafjes po i rritet pjerrtësia.

'Pushteti vendor' po koncentrohet në gjashtë veta; vendi po decentralizohet për t'u copëtuar. Negociatat po bëhen për t'iu nënshtruar realitetit në terren (Kosova e ndarë) dhe realitetit legal e juridik (Rezoluta 12-44 që e garanton sovranitetin e Serbisë mbi Kosovë). Populli është i sunduar. Tash, ai u dashka të nënshtrohet përfundimisht.

Gjashtë persona po bëjnë garën e hyrjes në histori me çfarëdo çmimi. Por, aty hyhet ndershëm ose poshtërsisht. E, ata po hyjnë poshtërsisht.

Prishtinë, 9 tetor 2005

Nëse duhet zgjedhur mes qyqarllëkut dhe dhunës, unë jam për këtë të dytën!  
Mahatma Ghandi

### Editorial

Në tri ditët e para të intervenimit të NATO-s kishte gëzim e shpresa, por mandej kishte shumë më tepër terror, frikë e panik. Posaçërisht nëpër qytetet e Kosovës, më parë shihej në televizor një cak i goditur (ndërtesë e shkatërruar) nga bombat e NATO-s, e vetëm pastaj eventualisht shihej edhe në realitet. Qyteteve, përjetimet gjatë bombardimeve të NATO-s më shumë u kujtohen si tmerr sesa si vuajtje, dhembje e sakrificë. E tmerrri është tmerr, sepse mbetesh i papërkur fizikisht. Pjekja është vetëm psikologjike.

Llogaria ndërkombëtare kishte dalë e gabueshme. Nuk kishte qenë e mjaftueshme që Milosheviqi të bombardohej vetëm për disa ditë. 78 ditë, 2 milionë shqiptarë mbetën nën mëshirën e forcave të tij. Ngase, aeroplanët e NATO-s bombardonin nga lart, madje nga shumë lart, vetëm që të mos kapeshin nga radarët e ushtrisë jugosllave. Nuk kishte trupa tokësore të NATO-s për të ndërhyrë, dhe as plan e përgatitje për to. Bombardimi i NATO-s ishte edhe eksperimentim nëse mund të fitohej lufta vetëm nga ajri dhe me zero viktima. Zero viktima nga radhët e ushtrisë së NATO-s, natyrisht. Sepse çmimi që paguan vendasit, ishte shumë i lartë: masakrat, dhunimet dhe shkatërrimet më të mëdha e më të shumta, ndodhën gjatë asaj kohe të luftës. Në emër të ndaljes së masakrave dhe ndaljes së luftës.

Megjithëse bombardimi i NATO-s ishte ndërmarrje e madhe ndërkombëtare, ajo ishte në diskrepancë të hatashme me premisat. Kësaj, më së shumti i kontribuoi pranimi paraprak i integritetit dhe sovranitetit të Jugosllavisë, të cilin e bënë përfaqësuesit shqiptarë nga Kosova në Konferencën e Rambujesë. Kjo, përfundimisht e ka pamundësuar intervenimin ushtarak ndërkombëtar me mandat politik. Prandaj, u tha se ai ishte vetëm intervenim humanitar, me qëllim që të parandalohet gjenocidi. Për pasojë, tani thonë se nuk kishte gjenocid në Kosovë sepse asnjë do të dilte se NATO ka dështuar, porse me atë rast edhe Kosovës automatikisht do të duhej t'i njëjhej e pranohej vetëvendosja deri në shkëputje. Rambujeja, me parimet e saj të panegociueshme që afirmojnë integritetin territorial dhe sovranitetin e Jugosllavisë, shënon defaktorizimin politik dhe ushtarak të Kosovës. Katër politikanët shqiptarë atje kishin pranuar shtetin që nuk e pranoi as vetë bashkësia ndërkombëtare: Jugosllavinë (e Milosheviqit). Ishte e qartë se paskëtaj vendim për Kosovën do të merreshin pa Kosovën. As pas shumë dëmeve e humbjeve, katër kalorësit e apokaliptës nuk e tërhoqën nënshkrimin e tyre, ngaqë ishin të preokupuar vetëm dhe vetëm me shpëtimin e tyre vetjak dhe me një çfarëdolloj grimë pushteti, të cilit tashmë po ia ndjenin aromën.

Argumenti për karakterin humanitar të intervenimit ishte veçse racionalizim. Shkaku i një veprimi nuk është e njëjta gjë me arsyetimin për atë veprim. Bombardimi ngjau vetëm pasi që Milosheviqi nuk e nënshkroi dokumentin e Rambujesë. Përdërisa Milosheviqi pranoi marrëveshjet (Dejtoni, marrëveshja Milosheviq-Hollbruk) ai konsiderohej paqebërës. Dokumenti i Rambujesë ishte shumë i pafavorshëm për Kosovën. Milosheviqi nuk e pranoi atë sepse nuk e pranoi aneksin ushtarak të dokumentit, ndërsa me pjesën politike ai s'kishte fare problem. Bombardimet i solli dështimi i Konferencës, jo sukcesi i saj. Bombardimet u ndalën kur Milosheviqi e pranoi dokumentin e Rambujesë, me 3 qershor 1999, që më vonë u përfshi edhe në Rezolutën 1244. OKB-ja nuk është pyetur kur ka intervenuar NATO-ja në Kosovë. Shumë thjeshtë: ajo nuk do të pajtohej. Dhe pikërisht misioni i saj, UNMIK-u, u vendos si administrim këtu.

Pra, me Milosheviqin gjithsesi ishte bërë kompromis. Populli, fillimin e intervenimit e pat përjetuar edhe si fillim të drejtësisë morale ndërkombëtare. Mirëpo, kjo mbeti vetëm kaq, pra përfundoi me fillimin. Si pasojë e Rambujesë, me marrëveshjen e Kumanovës dhe Rezolutën 1244, as nuk u dënuan shteti dhe regjimi serb, dhe as nuk u shpague populli i Kosovës për humbjet dhe vuajtjet. Serbisë iu vulos sovraniteti mbi Kosovën, me kusht që të mos e ushtronte atë përkohësisht. Sot, kthimin policor dhe ushtarak të Serbisë në Kosovë, nuk e pengojnë dokumentet zyrtare dhe legale, ndërkombëtare e vendore. Përkundrazi. E pengon vetëm gatishmëria e popullit të Kosovës për rezistencë dhe kryengritje, i cili ende nuk është thyer për dallim nga politikanët që i 'përfaqësojnë' ata nëpër institucionet e sistemit. Ndërkohë, intervencionizmi vazhdon. Siguria është militarizuar, parandalimi është doktrina. Krizë konsiderohet vetëm shpërthimi i krizës. Mbajten në prag të shpërthimit të krizës, e përjetëson pikërisht menaxhimi militarist i saj. KFOR-i kërkon tolerancë. Tolerancë edhe për joutolerancën e strukturave të Serbisë në Kosovë. Dhe, toleranca kërkohet nga ne pikërisht sepse ne jemi të shtypurit. Kësisoj, madje disi padashje, e pranojnë se kemi arsye që të mos tolerojmë.

Albin Kurti

# Fundi i një kaptine të errtë: NATO intervenon për të imponuar vetëvendosje (të brendshme) për Kosovën (mars - qershor 1999)

Pas Marrëveshjes së Dejtonit (1995), Dragoljub Mićunović, njëri ndër liderët opozitarë serb më me influencë, u ka thënë mediave se Serbia ndihet e relaksuar sepse komuniteti ndërkombëtar i ka njohur kufijtë e saj si kufij ndërkombëtar, duke përfshirë edhe territorin e Kosovës brenda atyre kufijve.<sup>1</sup> Opinion i njëjtë ka mbizotëruar edhe brenda qarqeve të regjimit serb dhe që nga atëherë ka qenë i përsëritur shpesh në publik.<sup>2</sup> Kjo gjendje e gjërave, e cila është përputhur gati në tërësi me qëndrimin ndërkombëtar lidhur me kufijtë që mund të kenë njohje potenciale ndërkombëtare, për dallim nga qëndrimi i shqiptarëve të Kosovës për të njëjtën çështje, zbulon dy gjëra që janë vendimtare për kuptimin e veprimeve të NATO-s kundër RFJ-së (mars - qershor 1999) dhe degëzimeve të mundshme të zhvillimeve në Kosovë dhe përreth saj, përfshirë këtu dhe statusin përfundimtar. Çështja e parë është e lidhur me vetë komunitetin ndërkombëtar, derisa e dyta është e lidhur me Kosovën dhe mundësitë e saj për të arritur shtetësinë duke qenë e ndarë nga RFJ dhe Serbia.

Qëndrimi i mësipërm i qarqeve serbe, si pozitës ashtu edhe opozitës, flet për asgjë tjetër veçse për profilin politik mbizotëruar në shoqërinë serbe në tërësi. Ky profil e merr për bazë shtetin si pikë referuese, e jo qytetarët apo individët e zakonshëm. Lidhur me çështjen e kufijve dhe vetëvendosjes në përgjithësi, ky qëndrim ka koiciduar me qasjen e komunitetit ndërkombëtar që nga fundi i Luftës së Ftohtë. Kjo do të thotë që komuniteti ndërkombëtar ka krijuar këtë profil politik serb. Profili i përhapur në Serbi e ka prejardhjen prej natyrës së nacionalizimit serb. Ajo që po argumentojmë ne është se qëndrimi i komunitetit ndërkombëtar për paprekshmërinë e kufijve të mëparshëm administrativ, ka çimentuar edhe më shumë mitet serbe për Kosovën dhe të drejtën e tyre a priori që pakundërshtueshëm të sundojnë popullatën shumicë të Kosovës.<sup>3</sup> Pse regjimi të Beogradit i janë dhënë garanci të tilla për paprekshmërinë e kufijve? Ka qenë kjo çështje e parimeve apo realpolitikë e pastër, që i ka marrë për bazë faktorët e tjerë gjeopolitik/gjeostrategjik? Ne do të provojmë të përgjigemi në këto pyetje në paragrafët e mëposhtëm.

Dy dilema kanë dalë në pah kur është diskutuar për intervenimin e NATO-s kundër RFJ-së (mars-qershor 1999). E para, dilema e realpolitikës, e bazuar në arsye gjeopolitike/gjeostrategjike e që nënkupton paprekshmërinë e kufijve, nuk ka qenë qëllim në vetvete, por efekt anësor i shqetësimit të NATO-s për paqen dhe stabilitetin në Ballkan dhe

më gjerë. Pas kësaj vjen dilema e bazuar në arsytet humanitare, qëndrim i proklamuar publikisht edhe nga zyrtarët e NATO-s, si para ashtu edhe pas intervenimit kundër RFJ-së.<sup>4</sup> Më pas edhe Sekretari i Përgjithshëm, Javier Solana, po ashtu i ka dhënë përparësi arsyeve humanitare qysh në ditën e fundit para se të fillonin goditjet ajrore me 24 mars 1999.<sup>5</sup> Në fakt, sa i përket përdorimit të forcës kundër RFJ-së, zyrtarët e NATO-s i janë referuar pothuajse ekskluzivisht arsyeve humanitare. Ky nuk ka qenë rasti, siç do ta shohim edhe më poshtë, gjatë fazave të hershme të konfliktit në Kosovë (shkurt-mars 1998 dhe më pas). Sido që të jetë, rezultati përfundimtar i goditjeve ajrore të NATO-s ka qenë ruajtja e integritetit territorial të RFJ-së dhe, për pasojë, Kosovës i është imponuar në fund të fundit vetëvendosje e brendshme. Kjo mbështetet pa dykuptimësi edhe në dispozitat e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (12 qershor 1999).

Çështjes që shtruan më herët, e që ka të bëjë me dilemën e dytë, nuk mund t'i jepet një përgjigje vetëm përmes besimit se aspekti humanitar është baza e fushatës ajrore të NATO-s kundër RFJ-së. Argumenti ynë bazohet në ngjarjet që i kanë paraprirë fushatës ajrore dhe në ngjarjet e mëpasme (janar - qershor 1999). Zotimet e NATO-s për krizën në Kosovë të bëra përmes njohimeve publike, pa mëdyshje i referohen miratimit të tërësishëm nga ana e NATO-s të rezolutave të deriatëherëshme të Këshillit të Sigurimit përkritazi me çështjen e Kosovës. Kjo do të thotë se aspekti humanitar në këto dokumente të Kombeve të Bashkuara nuk ka përparësi ndaj çështjeve tjera, sikurse kufijtë dhe çështjet tjera të afërta me këto (më së shumti ruajtja e paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar dhe zgjidhja e statusit final të Kosovës). Ky qëndrim i NATO-s më së miri reflektohet në dy dokumentet e kësaj periudhe: Marrëveshja e Rambujesë (shkurt-mars 1999) dhe Rezoluta e Këshillit të Sigurimit për Kosovën 1244 (12 qershor 1999). Dokumenti i dytë tani shërben si baza e vetme legale në të cilën bazohet administrata aktuale ndërkombëtare në Kosovë (si komponenti civil ashtu edhe ai ushtarak). Kur Grupi i Kontaktit për ish-Jugosllavinë pat lëshuar deklaratë me 19 janar 1999, duke u pajtuar që të thërres përfaqësuesit e RFJ-së, Qeverisë së Serbisë dhe përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës në Rambuje (Paris, Francë), e pat lidhur situatën e atëherëshme humanitare në Kosovë me çështjet e paqes, stabilitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së dhe shteteve fqinje si zgjidhja e vetme valide e krizës së

Kosovës.<sup>6</sup> Kjo deklaratë u pat miratuar tërësisht nga NATO me 30 janar 1999.<sup>7</sup> Në të dyja rastet, rezolutat e mëhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së u patën marrë tërësisht parasysh, duke e forcuar në këtë mënyrë edhe më tepër përkushtimin e komunitetit ndërkombëtar për integritetin territorial të RFJ-së dhe për ruajtjen e paqes dhe stabilitetit regional dhe më gjerë.<sup>8</sup>

Qëndrimi i mësipërm i komunitetit ndërkombëtar e përshkon tërë procesin negociator të mbajtur në Rambuje prej 6 shkurtit deri me 23 shkurt të vitit 1999.<sup>9</sup> Parimet e ashtuquajtura të panegociueshme që janë vënë për nënshkrim para ndonjë diskutimi në Rambuje e theksojnë paprekshmërinë e kufijve të RFJ-së, duke lënë që të kuptohet se çdo zgjidhje duhet të gjendet në kuadër të sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së. Me termet e vetëvendosjes, kjo praktikisht do të thotë se Kosova dhe popullata e saj shumicë, duhet të mbetet e kënaqur me të drejtën për vetëvendosje të brendshme. Kjo nuk ishte asgjë e re për shqiptarët e Kosovës. Një e drejtë si kjo për vetëvendosje të brendshme edhe më herët ka qenë e klasifikuar nga komuniteti ndërkombëtar si 'autonomi substanciale për Kosovën'.<sup>10</sup>

Sidoqoftë, së paku jo deri para Marrëveshjes së Rambujesë, pavarësisht nga krahasimi i mjegullt me autonomitë tjera ekzistuese, nuk është krijuar asnjë dokument i saktë që e tregon përmbajtjen e plotë. Ka qenë ky dokument që për herë të parë e ka specifikuar përmbajtjen e 'autonomisë substanciale' për Kosovën, megjithëqë për një periudhë të përkohshme trevjeçare.<sup>11</sup> Ky dokument garanton vetëqeverisje demokratike, paqe dhe siguri për gjithkë që jeton në Kosovë. Vetëqeverisja demokratike përfshin të gjitha çështjet e rëndësishme e që kanë të bëjnë me përditshmërinë si edukimi, përkujdesja shëndetësore dhe zhvillimi ekonomik. Kosova në bazë të kësaj marrëveshjeje do të kishte president, kuvend, gjyqet, qeverisje të fortë lokale, institucione të komuniteteve nacionale me autoritetin e nevojshëm për të mbrojtur identitetin e secilit komunitet. Siguria ka qenë e paraparë të garantohet nga trupat ndërkombëtare që kanë qenë paraparë të vendosen në Kosovë. Policia lokale, e përbërë nga përfaqësuesit e të gjitha bashkësive nacionale, ka qenë paraparë që të garantoj sundimin e ligjit. Forcat republikane dhe federale të sigurisë do të duhej ta lëshonin Kosovën. Përveç një pranie të kufizuar për mbrojtjen e kufirit. Çështja e fundit ka pasur të bëjë me mekanizmin për marrëveshjen përfundimtare. Në vijim të kësaj, Marrëveshja e

Rambujesë ka paraparë mbajtjen e një takimi ndërkombëtar pas 3 viteve për të përcaktuar mekanizmin për zgjidhjen e statusit final të Kosovës. Vullneti i popullit është paraparë që të merret parasysh në takim ndërkombëtar si një faktor i rëndësishëm.

Edhe përkundër garancioneve që i janë dhënë RFJ-së për integritetin dhe sovranitetin territorial, Beogradi ka refuzuar ta nënshkruaj dokumentin. Regjimi i Millosheviqit, në vend se të negocioj për planin e paqes të Rambujesë, e vazhdoi fushatën e tij të luftës në tërë territorin e Kosovës duke dëbuar qindra dhe mijëra shqiptarë nga shtëpitë e tyre. Situata humanitare në Kosovë që prej përfundimit të Konferencës së Rambujesë u pat bërë e atillë që paraqiste kërcënim real për paqen dhe stabilitetin regional, kështu që NATO nuk ka patur zgjidhje tjetër përveçse të veproj ashtu siç edhe pat deklaruar me deklaratën e saj të 30 janarit 1999. Sidoqoftë, nga koha e fillimit të bombardimeve të NATO-s me 24 mars 1999, diskursi i liderëve të NATO-s pat ndryshuar. Theksi është vënë më shumë në arsytet humanitare se sa në arsytet që lidhen me paqen dhe stabilitetin regional.<sup>12</sup> Megjithëkëtë, ky nuk ka qenë diskursi i Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 12 qershor 1999. Rregulli i radhitjes së çështjeve në këtë dokument duke pasur për bazë rëndësinë e tyre dallon po që se krahasohet me dokumentet e mëparshme. Në këtë rezolutë, sikurse edhe në të tjerat para kësaj që merrem me krizën e Kosovës, i është dhënë përparësi ruajtjes së paqes dhe sigurisë regjionale dhe integritetit e sovranitetit territorial të RFJ-së. Pas kësaj vijne çështjet humanitare (kthimi i refugjatëve dhe personave të zhvendosur) dhe marrëveshja finale për statusin e Kosovës, implementimi i vetëqeverisjes së përkohshme është po ashtu i përfshirë.<sup>13</sup> Në terma politik, kjo do të thotë se goditjet ajrore të NATO-s, në termat e vetëvendosjes, kanë rezultuar me ruajtjen e paqes dhe stabilitetit regional, ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të RFJ-së, mbrojtjen e popullatës shqiptare të Kosovës, dhe, përfundimisht, zgjidhjen politike të statusit të Kosovës duke i dhënë asaj 'autonomi substanciale'.<sup>14</sup>

Rezoluta 1244 riafirmon dhe aprovon tërësisht rezolutat e mëparshme të Këshillit të Sigurimit për krizën e Kosovës. Këto rezoluta, sikurse edhe rezoluta aktuale, thërresin për ruajtjen e integritetit territorial të RFJ-së dhe integritetin e shteteve fqinje të RFJ-së. Për më tepër, Rezoluta 1244 kodifikon formulën e G 8 për zgjidhjen politike të konfliktit të Kosovës, të miratuar me 6 maj të vitit 1999.<sup>15</sup> Kjo formulë e pasqyruar në

Rezolutën 1244 thotë që 'riafirmim thirrjen në rezolutat e mëparshme për autonomi substanciale për Kosovën'. Njëra ndër përgjegjësitë e prezencës civile ndërkombëtare në Kosovë është që të 'lehtësoj procesin politik të dizajnuar për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës, duke marrë parasysh Marrëveshjen e Rambujesë'. Rezultati përfundimtar i kësaj është që, së paku në sensin formal, politika e Serbisë së Madhe nuk është mundur, së paku jo përderisa komuniteti ndërkombëtar e trajton Kosovën si pjesë përbërëse të RFJ-së së dominuar nga serbët. Prapë në sensin formal, ka ngjashmëri të habitshme mes pozitës së Kosovës dhe 'Republikës Serbe' në Bosnjë dhe Hercegovinë.

## Shënime:

<sup>1</sup> Pesë vite më vonë, megjithatë, Mićunović nuk ishte i sigurt për këtë. Duke kritikuar planet për shkëputje që nga qershori i vitit 2001 (afati i fundit i vënë për mbajtjen e referendumit për pavarësinë e kësaj republike), Mićunović ka thënë që shkëputja e Malit të Zi nga RFJ (Serbia dhe Mali i Zi) do ta bënte po ashtu shumë të gjashme shkëputjen e Kosovës, duke vënë kështu në rrezik mbijetimin e RFJ. Cf. Radio Slobodna Evropa, 04/01/2001. 10.00 CET (In South Slavic Languages).

<sup>2</sup> Duke iu referuar të ashtuquajturës Marrëveshja e Kumanovës, e cila ka mundësuar futjen e trupave të NATO-s në Kosovë në qershor të vitit 1999 dhe promulgimin e Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së (qershor 12, 1999), Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Jugosllave, Nebojsa Pavković, ka deklaruar për media në Beograd që ata (serbët) mbajnë të drejtën mbi Kosovën sepse që të dy dokumentet e sipërpërmenduar njohin dhe garantojnë integritetin dhe sovranitetin e Republikës Federative të Jugosllavisë. Cf. Radio Slobodna Evropa (In south Slavic Languages), 17 dhjetor 1999, 10:00h p.m. CET.

<sup>3</sup> Për pikëpamje identike, shih, Noel Malcolm, Kosovo. A short History; Tim Judah, Kosovo. War and Revenge (New Haven and London: Yale University Press, 2000); Steven Schwartz, Kosovo. Background to a War (London: Anthem Press, 2000); Julie A. Mertus, Kosovo. How Myths and Truths Started a War (California: University of California Press, 1999); Greg Campbell, The Road to Kosovo. (Boulder and Oxford: Westview Press, 1999); Warren Zimmermann, 'The Demons of Kosovo'. The National Interest No. 52 (Spring 1998) pp. 3-13 at 5-6; Aleksa Djilas, 'Imaging Kosovo'. Foreign Affairs Vol. 77 No. 3 (shtator/tetor 1998) pp. 124-131; Shlomo Avineri, 'The Future of Kosovo' East European Constitutional Review Vol.8 No.3 (Summer 1999) pp. 1-4 (në internet <http://www.law.nyu>).

<sup>4</sup> Ky qëllim është shprehur qartë nga Këshilli i NATO-s në deklaratën e tij speciale për Kosovën me 8 dhjetor 1998, duke argumentuar se "Qëllimi i NATO-s është që t'i kontribuoj përpjekjeve ndërkombëtare për të ndaluar krizën humanitare në Kosovë, për t'i dhënë fund dhunës dhe për të gjetur një zgjidhje të përhershme të krizës në Kosovë". Teksti i plotë mund të gjendet në 'Qendra Informative e Kosovës - QIK',

Raporti ditor No. 2264 B (Prishtinë), 8 dhjetor 1998 (vetëm versioni shqip). Në anën tjetër studiuesit janë të ndarë përkitazi me këtë. Ata më me ndikim siç është Thomas Franck ose Antonio Cassese, kanë favorizuar aspektin humanitar. Shih, Antonio Cassese, 'Ex Injuria lus oritur: Are We Moving Towards International legitimation of Forcible Humanitarian Countermeasures in the World Community?'. Comment on Bruno Sima, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects' European Journal of International Law Vol. 10 No 1 (1999) pp. 23-31; Louis Henkin, "Kosovo and the Law of 'Humanitarian Intervention' American Journal of International Law Vol 93 No.4 (tetor 1999) pp. 824-828; Ruth Wedgwood, 'NATO-s Campaign in Yugoslavia' American Journal of International Law Vol. 93 No4 (tetor 1999) pp 828-834; Richard Falk, 'Kosovo, World Order and the Future of the International Law' American Journal of International Law Vol 93No. 4 (tetor 1999) pp. 847-857; Thomas M. Frank, 'Lessons of Kosovo' American Journal of International Law Vol 93No. 4 (tetor 1999) pp. 860-863; Në fakt, shumica e autorëve kanë qëndrim se pozita e Kosovës në Evropë ka luajtur një rol të rëndësishëm në kalkulimet e NATO-s për ta goditur RFJ-në (Serbinë dhe Malin e Zi). Grupi i fundit i autorëve, i cili më së shumti, nuk i mbështet aksionet e NATO-s kundër Jugosllavisë, duke i dhënë kështu përparësi sovranitetit dhe parimit të mosintervenimit në çështjet e brendshme të shteteve të pavarura dhe sovra. Cf Bruno Sima, 'NATO, the UN and the Use of Force: Legal Aspects'. European Journal of International Law Vol. 10 No 1 (1999) pp. 23-31; Jonathan I. Charney, 'Anticipatory Humanitarian Intervention in Kosovo' American Journal of International Law Vol. 93 No.4 (tetor 1999) pp. 834-841; Christine M. Chinkin, 'Kosovo: A 'Good' or 'Bad' War?' American Journal of International Law Vol. 93 No.4 (tetor 1999) pp. 841-847; Mary Ellen O'Connell, 'The UN, NATO, and International Law after Kosovo' Human Rights Quarterly, Vol.22 No. 1 (shkurt 2000) pp. 57-89. Për zyrtarët e NATO-s kjo ka qenë e qartë se vendimi për të hyrë në Kosovë nuk ka vendosur ndonjë precedent për aksionet e saj të ardhshme gjeti, sikurse janë frikësuar disa rusë apo edhe siç kanë shpresuar disa Evropa Lindore. Shih, Paul Goble, 'Another Precedent From Kosovo?' RFE/RL Newsline. 9 nëntor 2000 (në internet <http://www.rferl.org>).<sup>5</sup> Shih, Deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm e datës 23 mars 1999 (në internet: <http://www.nato.com>). Kur ka filluar fushata ajrore, liderët e NATO-s i janë referuar në mënyrë më eksplicite aspektit humanitar si bazë për aksionet e tyre kundër RFJ-së. Shih, Bill Clinton, Ne Luftën, Ju Paqen. Mesazhe, Artikuj, Konferenca Shtypi, Intervista dhe Fjalime për Kosovën. (Tiranë: Gazeta 'Albania', 2000). E suksesshme apo e dështuar fushata ajrore e NATO-s kundër RFJ-së, një gjë e rëndësishme që duhet kuptuar janë qëllimet paraprake të Aleancës. Këto qëllime kanë ndryshuar gjatë fushatës ajrore. Që në fillim administrata e Klintoni ka përmendur tri qëllime për fushatën bombarduese kundër RFJ-së: a) për të dëshmuar seriozitetin e NATO-s për të kundërshtuar agresionin; b) për të ndaluar sulmet e vazhdueshme dhe eskaluese të Millosheviqit në Kosovë; c) për të shkatërruar kapacitetin e Serbisë për të kryer luftëra në të ardhmën. Cf.R.W.Apple, Jr., 'A Fresh Set of US Goals'. New Yourk Times (25 mars 1999) p. A1 ; Shih, po ashtu, Barton Gellman. 'Allies Facing the Limits of Air Power'. Washington Post. 28 mars 1999, p. A1. Qëndrime të njëjta janë reflektuar në deklaratat e NATO-s gjatë krizës në Kosovë. Deklaratat kanë kërkuar që Millosheviq'i t'i jap fund represionit në Kosovë, t'i tërheq forcat nga provinca, të pajtohet me një prani ushtarake ndërkombëtare në provincë, sikurse edhe të garantoj kthimin e refugjatëve dhe personave të

zhvendosur, dhe po ashtu të garantoj se do të punoj në përputhje me kornizën politike të Marrëveshjes së Rambujesë. Cf. Deklaratë e lëshuar në takimin e jashtëzakonshëm të ministrave të Këshillit të Aleancës Veriatlantike, Shtabi i NATO-s, Bruksel, 12 prill 1999 dhe Deklaratë për Kosovën, e lëshuar nga shefat e shteteve dhe qeverive që kanë marrë pjesë në takimin e ministrave të Këshillit të Aleancës Veriatlantike në Washington, D.C. 23-24 prill 1999. (në internet: <http://www.nato.com>).<sup>6</sup> 'Big Powers Demand a Deal on Kosovo Within Weeks'. Qendra për Informim e Kosovës. Raporti ditor No. 1677, Prishtinë 19 janar 1999; 'Contact Group Sets Deadline for Kosovo Agreement'. Radio Europa e Lirë/RL Newsline. Vol. 3 No. 31 Part II, 15 shkurt 1999.<sup>7</sup> Shih, 'NATO Statement on Kosovo'. 30 janar 1999. Qendra për Informim e Kosovës. Raporti ditor No. 1679. 31 janar 1999.<sup>8</sup> Shih rezolutat e mëparshme të Këshillit të Sigurimit të KB-ve: Rezoluta 1160 (31 mars 1998); Rezoluta 1199 (23 shtator 1998); Rezoluta 1203 (24 tetor 1998). (në internet <http://www.un.org>).<sup>9</sup> Procesi paqësor i Rambujesë ka përfunduar me nënshkrimin Marrëveshjes së Rambujesë në Paris me 19 mars 1999.<sup>10</sup> Në esencë, duke pasur parasysh autonominë për Kosovën, mund të thuhet se ka pasur modele të ndryshme në të kaluarën, megjithëse jo të specifikuar. Modelet e këilla kanë qenë të propozuara nga komuniteti ndërkombëtar sikurse edhe nga vetë palët. Ato zakonisht e kanë përcjellur linjën e komunitetit ndërkombëtar. Cf. Dimitros Triantophollou. 'Kosovo Today: Is there No What Out of the Deadlock?' European Security Vol.5 No.2 (verë 1996) pp 291-292; Zoran Lutova, 'Options for the Solution of the Problem of Kosovo' International Affairs No. 1056. Beograd, 15 maj 1997 pp 10-14. Modeli i parë ka konsistuar në garantimin për Kosovën të një autonomie të tipit të vitit 1974. Ky opcion është propozuar më së shumti nga qarqe të komunitetit ndërkombëtar. Për herë të parë versioni i saj është bërë publik nga Grupi Special për Kosovën (që vepronte në kuadër të Grupit Punues për Minoritetet Etnike dhe Kombëtare të Konferencës Ndërkombëtare për ish Jugosllavinë) dhe ka mbetur si variant deri në fillim të konfliktit në Kosovë në shkurt të vitit 1998. Ky model, i draftuar nga kryesuesi i Grupit Special për Kosovën, ambasadori gjerman, Gerht Ahrens, ka paraparë autonomi për Kosovën të bazuar në Kushtetutën e Jugosllavisë të vitit 1974 dhe në përvojat e Tirolit Jugor, Spanjës, Ishujve Aland, Bosnë e Hercegovinës dhe Kroacisë (i ashtuquajtur 'Plani Z' i draftuar për serbët që jetonin në Kroaci). Cf. Hugh Poulton, 'The Rest of the Balkans'. In Hugh Miall (ed.), Minority Rights in Europe. The Scope for the Transitional Regime (London: Royal Institute of International Affairs, 1994) pp. 71-72. Modeli i dytë merret me riefederalizimin e Jugosllavisë (Serbisë dhe Malit të Zi). Ky model nënkupton federalizim të ri ose shtesë të RFJ-së, duke e bërë Kosovën, përveç Serbisë dhe Malit të Zi, njësi të ndarë federale, e që do të thotë, republikë e tretë. Kjo ka qenë ekzaktesisht ajo që shqiptarët e Kosovës kanë kërkuar në trazirat e vitit 1981. Sidoqoftë, që nga shpërbërja e Jugosllavisë, ky solucion është konsideruar si një solucion i vjetëruar. Nga ana e serbëve ky propozim është mbështetur nga lideri i të ashtuquajturës Lëvizje Serbe për Rezistencë, Momçillo Trajković. Cf. Carl Bildt, 'Kosovo Should Have the Same Status as Montenegro' Qendra për Informim e Kosovës, Raporti Ditor No. 1736 (3 qershor 1997), Prishtinë (vetëm në versionin shqip). M.Trajković në shumë raste ka kërkuar që Kosova të bëhet republikë e tretë në kuadër të Jugosllavisë. Në një rast, Trajković është kërcënuar se nëse kosovarët nuk e pranojnë këtë ofertë, atëherë do të ketë fushatë ushtarake kundër Kosovës. Cf. Qendra për Informim e Kosovës. Raporti Ditor No. 1945 (20 janar 1997), Prishtinë (vetëm versioni shqip).<sup>11</sup> Marrëveshja për Paqe e Rambujesë përmban po ashtu edhe të ashtuquajturat parime të panegociueshme (të përmendura më herët), ku i jepet përparësi çështjes së integritetit dhe sovranitetit territorial të Jugosllavisë. Shih, Marrëveshja e përkohshme për paqe dhe vetëqeverisje në Kosovë. Teksti i saj është në Thanos M. Veremis and Dimitros Traintaphyllou

(eds.), Kosovo and the Albanian Dimension in Southeastern Europe: The Need For Regional Security and Conflict Prevention (Athens: ELIAMEP, 1999) pp. 261-330.

<sup>12</sup> Në fakt, duke e lënë mënjanë integritetin territorial të Jugosllavisë stabilitetin dhe sigurinë regionale dhe situatën humanitare në Kosovë, është vetëm një rast kur NATO qartë i shpreh qëllimet politike të intervenimit të saj në Kosovë. Do të thotë, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, me 22 janar të vitit 1999, ka thënë se qëllimi politik i NATO-s është që t'ia kthejë Kosovës statusin autonom që e ka gëzuar në bazë të Kushtetutës së Jugosllavisë të vitit 1974. Kjo praktikisht do të thotë se intervenimi ushtarak do të ketë si rezultat, nëse jo si qëllim të drejtpërdrejtë, imponimin e statusit autonom për Kosovën (vetëvendosje të brendshme) status të cilin ajo e ka gëzuar gjatë sundimit të Titos. Cf. Qendra për Informim e Kosovës. Raporti Ditor No. 2308 B (Prishtinë), 22 janar 1999.

<sup>13</sup> Dy ndërmjetësuesit ndërkombëtar, njëri në emër të UE (Marti Ahtisar-i) dhe tjetri në emër të Federatës Ruse (Victor Chernomerdin) kanë nxjerrur në shesh më vonë që Millosheviq'i ka pranuar kushtet e NATO-s për dorëzim kur atij i janë dhënë nga ndërmjetësuesit garancione se misioni ndërkombëtar në Kosovë do të jetë në UN dhe mbi të gjitha se komuniteti ndërkombëtar do të ruaj sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë mbi Kosovën. Cf. The UN Document: S/1999/699 (datë 2 qershor 1999). Për komentet e të dy ndërmjetësuesve, shih, Victor Chernomerdin, 'Nismo Izdaju Srbiju'. (Intervistë). Javorja beogradase NIN (Beograd), 14 tetor 1999; Marti Ahtisari, 'Nuk e Kam Kërcënuar Millosheviqin'. E përditshmeja prishtinase Kosova Sot, 26 korrik 2000, faqe 8.<sup>14</sup> Pavarësisht nga pronicimet e NATO-s për çështjet politike, sikurse çështja që ka të bëjë me statusin autonom të vitit 1974 që shqiptarët e kanë gëzuar gjatë sundimit të Titos, disa zyrtarë perëndimor që në fazën e parë të konfliktit në Kosovë, kanë dhënë deklarata të atilla që i referohen përkushtimit perëndimor për integritetin territorial të RFJ-së. Në këtë mënyrë, Robert Gelbart, i dërguari i posaçëm i SHBA-ve për Kosovë, në vizitën e tij në Prishtinë në fillim të marsit, padashur e ka nënvizuar validitetin e opcionit paqësor duke zbuluar kështu mbështetjen amerikane dhe të të tjerëve (kryesisht të vendeve anëtare të NATO-s) për integritetin e Jugosllavisë. Kjo, i ka lënë Millosheviqit duart e lira për të dëbuar polhuajse tërë popullatën e Kosovës, për të vrarë civilë të pafajshëm, dhe për të aplikuar politikën e tokës së djegur. Shih, për kritikën e këtij qëndrimi perëndimor, Miles Pomper, NATO Readies Strike Plans Against Serbia. CO Weekly. 07/25/98, Vol.56 Issue 30, p. 203; James Brady, 'History Proves again Balkans Bite is Worse than its Bark'. Advertising Age. 07/13/1999, Vol.69 Issue 28 p. 25; Roland Steel, 'Hijacked'. New Republic. 07/13/1998, Vol. 219 Issue 2, p. 10; Johnatan Landy, 'NATO-s Drums Beat Louder Over Kosovo'. Christian Science Monitor. 09/25/98, Vol. 90 issue 212, p.1; Justin brown, 'living Cross hairs of NATO'. Christian Science Monitor. 10/07/98, Vol. 90 issue 90, Issue 230 p.1; Mark Dennis, 'Locked and Loaded'. Newsweek. 10/09/98. Vol. 132, Issue 16, p. 50; Micheal Hirsch et al., 'Holbrooke's Nery Game of Chicken'. Newsweek. 10/26/98, Vol. 132 issue 17, p.50; Richard Newman, 'NATO-s patience is Wearing Thin'. Us News and World Report. 10/09/98. Vol. 125 Issue 15,p. 40; Justin Brown, 'Uncomfortable Peace in Kosovo'. Christian Science monitor. 10/08/98 Vol.90 issue 224, p.1; Jansuz Bugajski, 'Act Now in Kosovo or Regret Later'. Christian Science monitor. 03/11/98. Vol. 90 Issue72, p. 19 (këta artikuj janë në internet në adresën <http://www.gwz.epnet.com>).

<sup>15</sup> Shih dokumentin e KB-ve S/1999/516. (në internet <http://www.un.org>).

Ky tekst është pjesë (faqe 239-248) nga libri "Self-Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia" i autorit Enver Hasani.

Ky tekst është përkthyer nga Shkëlzen Gashi

# Iniciativa e Rugovës, Besnik Mustafaj dhe Marti Ahtisari

Shkëlzen Gashi

1. Deputetët e Kuvendit të Kosovës pa asnjë votë kundër (PDK absteno), i dhanë të mërkurën mbështetje iniciativës së kryetarit Ibrahim Rugova për emërimin e grupit të lartë politik, i cili do të drejtojë bisedimet për statusin politik të Kosovës. Ndërsa, PDK-ja ka insistuar që të formohet formacioni për bisedime për modalitetet e implementimit të vullnetit të popullit, që Kosova duhet të zhvillojë me bashkësinë ndërkombëtare, Bashkimin Evropian dhe me vendet fqinje. Pra, sipas tyre, Kosova nuk do të bisedojë me Serbinë, por me bashkësinë ndërkombëtare dhe vendet fqinje. Ky është mashtrim! Grupi kosovar për negociatën do të bisedojë me Serbinë, për të definuar statusin final të Kosovës. Këtë e dëshmon, përveç tjerash, edhe intervista e zyrtares së lartë të UNMIK-ut, Hua Jiang, për radion BBC, e cila ka thënë se Beogradi duhet të ulet së bashku me bashkësinë ndërkombëtare dhe kosovarët për të vendosur për një status i cili do të ishte i pranueshëm jo vetëm për kosovarët, por edhe për rajonin... Gatishmëria e IPVQ-ve për të hyrë në procesin e negociatave është institucionalizim i mohimit të vullnetit të popullit. Shkelje mizore mbi gjakun e derdhur përgjatë përpjekjeve për liri.

2. Ministri i Punëve të Jashtme të Shqipërisë, Besnik Mustafaj, ka theksuar për agjencinë Reuters se Kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, i ka thënë Javier Solanës në OKB se të gjitha shtetet e Ballkanit pajtohen, se kufijtë nuk do të ndryshojnë, përfshirë këtu edhe kufijtë e Kosovës. Për të shtuar më pas se negociatat duhet të fillojnë sa më shpejt të jetë e mundur, tani pasi që të Kryetari i Kosovës, Ibrahim Rugova, është diagnostifikuar kanceri në mushkëri, për arsye se ai paraqet një figurë të pazëvendësueshme, i cili posedon guximin që të bëjë kompromise. Pra, shteti shqiptar është për pavarësi të kushtëzuar, e kjo nënkupton pavarësinë pa sovranitet. Siç u tha edhe më sipër, shteti shqiptar është pajtuar që të mos ndryshohen kufijtë dhe të bëhet kompromis. Fare në fund, duhet thënë se pavarësia e kushtëzuar, mosndryshimi i kufijve dhe kompromisi do të thonë shkelje e vullnetit politik të popullit të Kosovës.

3. Këtyre ditëve është folur jashtëzakonisht shumë për ndërmjetësuesin ndërkombëtar për përcaktimin e statusit të Kosovës. Bile-bile, edhe PSSP-ja, Soren Jessen Petersen, në një konferencë për shtyp, tha se ka shumë gjasa që ndërmjetësues ndërkombëtar për zgjidhjen e problemit të Kosovës të jetë ish-Presidenti i Finlandës, Marti Ahtisaari. Është shumë e habitshme se si nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes (IPVQ-të), por edhe nga partitë politike është mirëpritur ideja që Ahtisaari të jetë ndërmjetësues. Siç duket, këtu ndër ne është harruar një fakt tepër i rëndësishëm: Marti Ahtisaari është njeriu që e ka shpëtuar RFJ-në gjatë bombardimeve të NATO-s. Ahtisaari me 3 qershor të vitit 1999 ka bindur Millosheviqin dhe Parlamentin e Serbisë që të pranojnë planin e paqes të bashkësisë ndërkombëtare, i cili plan, përveçse e ka marrë tërësisht parasysh Marrëveshjen e Rambujesë, ka garantuar sovranitetin dhe integritetin territorial të Jugosllavisë dhe për më tepër, ka paraparë demilitarizimin e UÇK-së.

# Për çfarë ka intervenuar NATO në Kosovë?!

Shkëlzen Gashi

Në asnjërën rezolutë për Kosovën të miratuar nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së, nuk është autorizuar përdorimi i forcës nga ndonjë entitet i jashtëm, përveçse u është bërë thirrje palëve në konflikt që të ndalin dhunën. Bile-bile, në të gjitha këto rezoluta është riafirmuar sovraniteti dhe integriteti territorial i RFJ-së. Pra, nuk ka pasur autorizim të OKB-së për bombardimet e NATO-s, edhe pse disa konsiderojnë se me aprovimin e Rezolutës 1244 realisht miratohen bombardimet e NATO-s, por ky nuk është autorizim ab initio. Në fund të fundit, nuk është edhe aq e rëndësishme se a ka qenë ky intervenim legal, sa e rëndësishme është të zërthehet se për çfarë në të vërtetë është bërë ky intervenim?! Është çli-ruar Kosova me intervenimin e NATO-s, apo është ruajtur integriteti dhe sovraniteti territorial i Jugosllavisë?!

Shumë ekspertë, posaçërisht ata të së drejtës ndërkombëtare, në esetë e tyre, të botuara kryesisht në American Journal of International Law, konsiderojnë se aksioni i NATO-s ishte disenjuar për të shtrënguar Qeverinë Jugosllave që të pranojë planin e paqes për Kosovën dhe për më tepër, këtë e thotë edhe gjenerali Wesley K. Clark në librin e tij "Të bësh luftë moderne" (faqe 469). Madje, madje, vetë gjenerali Wesley K. Clark e pranon se sikur të kishin nisur që në fillim përgatitjet për intervenim tokësor do të shpëtoheshin shumë njerëz të pafajshëm: "Jam i bindur që planet dhe përgatitjet për intervenim tokësor e kanë bindur Millosheviqin që të dorëzohet" ("Të bësh luftë moderne", faqe 471) Pra, vërehet se NATO nuk ka qenë edhe aq e shqetësuar për të zbrapsur sulmin e armatosur të forcave serbe mbi popullatën civile shqiptare. Edhe kë-

të e dëshmon vetë deklarata e gjeneralit Wesley K. Clark, komandant suprem i NATO-s gjatë bombardimeve në Kosovë, i cili thotë se ashpërsimi i dhunës dhe mizorive të forcave serbe pas fillimit të bombardimeve të NATO-s ka qenë krejt i parashikueshëm. Andaj, Noam Chomsky ka të drejtë kur thotë se në rast të paraqitjes së krizës humanitare, bota e jashtme ka tri mundësi: të veprojë për ta rënduar katastrofën; të mos veprojë fare; dhe të veprojë për ta zbutur katastrofën; Kosova i takon kategorisë së parë për arsye se: deportimi i afërsisht një milion njerëzve ka ndodhur pas fillimit të intervenimit të NATO-s dhe se pjesa dërrmuese e vrasjeve kundër civilëve ka ndodhur po ashtu pas fillimit të intervenimit të NATO-s.

Pasiqë bashkësia ndërkombëtare ka qenë shumë e preokupuar me fatin e qytetarëve të Kosovës, dhe pasiqë qëllimet e saj kanë qenë qëllime humanitare, atëherë pse ajo ka vendosur që para fillimit të intervenimit të NATO-s t'i lë qytetarët e Kosovës nën mëshirën e regjimit të Millosheviqit duke e larguar KVM-në nga Kosova?!... Një shkrimtar serb, Vladimir Arsenijeviq, në ditarin e tij për luftën, "Mexico - Ditari i luftës", thotë: "Është fakt i pamohueshëm që NATO e ka mbështetur drejtpërdrejt Sllobodan Millosheviqin duke ndihmuar që ta ndërmarrë këtë valë të fundit të mizorive gjithandej në Kosovë, si dhe ta forcojë kontrollin e tij në gjithë Jugosllavinë. Përdërisa NATO zhvillon luftën e vet komode nga ajri, civilët shqiptarë janë lënë në mëshirën e forcave ushtarake dhe paramilitare serbe atje poshtë në terren" (faqe 121).

Nëse intervenimi i NATO-s është bërë kundër pastrimit etnik, siç edhe thotë Tzvetan Todorov, atëherë rezultati final, përkundrazi, ka qenë ai i forcimit të pastrimit etnik. Jo

vetëm pse pas fillimit të bombardimeve të NATO-s janë deportuar afërsisht një milion shqiptarë, por edhe për faktin se pas përfundimit të këtyre bombardimeve dhe vendosjes së trupave të NATO-s, është krijuar një Kosovë pothuajse etnikisht homogjene nga ku janë përjashtuar minoritarët. Intervenimi i NATO-s nuk është bërë për ta çliruar Kosovën, por për ta shtrënguar palën serbe ta pranojë planin e paqes, e ai plan jo vetëm se ka garantuar që NATO-ja të ketë qarkullim të lirë nëpër tërë RFJ-në, por ka garantuar edhe mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial të Jugosllavisë (qëllimi ka qenë që të ruhet paqja dhe stabiliteti ndërkombëtar) dhe këtë më së miri e dëshmon dokumenti i 3 qershorit të vitit 1999 (Ahtisaar-i dhe Chernomerdin-i)... Po këtë - pra se rezultati përfundimtar i bombardimeve të NATO-s ka qenë ruajtja e integritetit territorial të Jugosllavisë dhe si rrjedhojë Kosovës i është imponuar vetëvendosje e brendshme - e thotë edhe një ekspert kosovar në faqe 242 të librit e tij "Self Determination, Territorial Integrity and International Stability: The Case of Yugoslavia" të botuar nga një institut prestigjioz vjenez për zgjidhjen e konflikteve.

NATO ka rezultuar e sukseshme: pala serbe e ka pranuar me 3 qershor dokumentin e Ahtisaar-it dhe Chernomerdin-it prej 10 pikash, ku pika tetë e merr tërësisht parasysh Marrëveshjen e Rambujesë dhe integritetin e sovranitetin territorial të Jugosllavisë. Nga kjo rrjedhë se Parlamenti i Serbisë dhe ish-Presidenti Millosheviq, me 3 qershor e kanë pranuar Marrëveshjen e Rambujesë. Zaten, intervenimi i NATO-s është bërë, siç u tha edhe më sipër, për t'u pranuar Marrëveshja e Rambujesë, e kjo marrëveshje, siç thuhet, veç tje-

rash, në Kapitullin 7 të saj - Shtojcat - Shtojca B: Statusi i forcave implementuese multinationale, pika 8, garanton që "personeli i NATO-s do të gëzojë së bashku me automjetet, aeroplanët, mbajtësit dhe mjetet e tij, qarkullim të lirë, të pakufizuar dhe hyrje të papenguar nëpër tërë RFJ-në, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe ujërat territoriale..."

Pra, në bazë të Marrëveshjes së Rambujesë që paraparë që trupat e NATO-s të mund të vendosen në gjithë territorin e ish-Jugosllavisë dhe po ashtu, në bazë të asaj marrëveshjeje që paraparë që në Kosovë të mbesin 2500 trupa të MUP-it, kurse 1500 trupa të armatës jugosllave si roje të kufirit... Mirëpo, pas intervenimit të NATO-s për shkak të situatës së krijuar vendoset që të mos mbesin trupat serbe që ka qenë paraparë të mbesin në Kosovë, por të kthehen më vonë kur të vlerësohet nga ndërkombëtarët se për një gjë të tillë janë pjekur kushtet - legalisht s'ka asfarë pengese; dhe po ashtu për shkak të situatës së krijuar as trupat e NATO-s s'do të kenë të drejtë të vendosen në territorin e ish-Jugosllavisë tash SMZ-së...

Është me rëndësi të thuhet se në një deklaratë të dhënë me 23 shtator të vitit 1999, në gazetën Washington Post, ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s Javier Solana, ka thënë se "Shqiptarët e Kosovës duhet të heqin dorë nga shpresat e tyre se do të fitojnë pavarësinë duke e ndarë provincën nga Serbia. Ata duhet të heqin dorë nga qëllimet e tyre. Po që se komuniteti ndërkombëtar lejon ndryshimin e kufijve në Serbinë jugore do të ishte e vështirë të ndalohej ndarja në vendet tjera të Ballkanit, dhe mbase edhe në pjesë të territorit të Rusisë"

Për më tepër se kaq, edhe presidenti i atëhershëm amerikan,

Bill Clinton, gjatë bombardimeve të NATO-s, në një fjalim drejtuar popullit serb, pat deklaruar: "aleatët e NATO-s mbështesin popullin serb për ruajtjen e Kosovës si pjesë e vendit tuaj." (Henry Kissinger, "Dëmtimi i Historisë", botuar në librin "Lufta kundër luftës" në faqe 232-236.) Po të njëjtën gjë e pat thënë edhe ish-sekretarja amerikane Albright, në një intervistë dhënë kanalit televiziv CNN, me 21 shkurt të vitit 1999...

Fare në fund, me intervenimin e NATO-s nuk është suprimuar sovraniteti i Jugosllavisë ndaj Kosovës - pra sovraniteti de facto se ai de jure garantohet me rezolutën 1244 - por vetëm është suspenduar. Në vijim të kësaj, duhet thënë se garantimi i sovranitetit dhe integritetit territorial të ish RFJ-së, tash SMZ-së, do të ketë reperkusione të drejtpërdrejta në definimin e statusit final të Kosovës dhe se nuk duhet të merret jo seriozisht deklarata e Solanës me rastin e vizitës së mëhershme në Prishtinë, ku në një intervistë dhënë RTK-së inter alia tha: e vetmja gjë që mund të them është nuk do të ketë kthim të Kosovës në gjendjen para vitit 1999, dhe se e ardhmja e Kosovës është në Evropë. Tash shtrohet pyetja: E ardhmja e Kosovës në Evropë si shtet i pavarur apo si pjesë e Unionit Serbi Mali i Zi, ngase e kemi të qartë që ardhmja e Kosovës nuk është në Azi?!

Lord Robertson, ish-Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s, në një vjetorin e sulmeve të NATO-s në Kosovë, kur bën fjalë për qëllimet e këtij intervenimi, thotë se ndër kërkesat që është dashur Millosheviq të plotësojë për t'u ndalur bombardimet e NATO-s, ka qenë edhe garantimi i një gatishmërie të besueshme për të punuar mbi bazën e bisedimeve të Rambujesë, në krijimin e një plan-marrëveshjeje politike për Kosovën.

Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

**VETËVENDOSJE!**

**KOPJIMI LEJOHET.  
TË LUTEM KOPJOJE!**

Rr. Perandori Justinian, p. n.  
Qyteza Pejton  
Prishtinë, Kosovë

038 222 704  
vetevendosje@hotmail.com  
vetevendosje@yahoo.com  
vetevendosje@gmail.com  
www.vetevendosje.org